

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbim-Menaxhim mbetjesh urbane, në landfill (me makineri të rënda)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Buldozerë - 43211000-5, Eskavatorë mekanikë - 43262100-8, Sherbime të ndryshme - 98300000-6.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 54.804.750 (pesedhjetë e katër milion e tetëqind e katërmijë e shtatëqind e pesedhjetë) Leke pa TVSH
Dhe 525.453 (pesëqind e njëzet e pesëmijë e katërqind e pesedhjetë e tre) Euro**

Bazuar ne kursin zyrtar te këmbimit per ditën e sotme.

Ndarja ne LOTE: JO

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, ka argumentuar mosndarjen e procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- b a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
-) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në kreun V, **Neni 42, pikat 1 dhe 2** të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

- 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
- 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur.

Legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojen për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike,

duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, vendosi të mos e ndajë në lote këtë procedurë prokurimi, pasi nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura më shumë.

Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/Enti kontraktor Shoqëria “ECO – ELB” sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i shërbimeve me çmimet për çdo zë (sipas shtojcës 6)

<p>Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p>

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 8)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1** Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 50% e vleres separashikuar të kontratës që po prokurohet.

<p>Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p>
--

- 2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhenenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- 2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 5/ c), pika 6, nenit 43, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku ndër të tjerapercaktohet: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* si dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për proceduratatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 50 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve/sherbimit, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar,
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim kur ka përfunduar periudha e garancisë së punimeve / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim kur objekti është në periudhë garancie punimesh

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve/shebrimit, shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Përveç sa me sipër, kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, nëveçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarësi dhe nënenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të

fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Licenca Profesionale të lëshuar nga Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI ose nga institucionet e autorizuar me ligj si më poshtë:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat emëposhtme:**
- NP-12 A "Punime të inxhinierisë së mjedisit".
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:**
- NS-17 A "Ndertime te impianteve te grumbullimit dhe te trajtimit te mbetjeve urbane"

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuar nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i diplomuar ne Inxhinieri Mjedisi, te certifikuar nga Ministria e Mjedisit per hartimin e Raporteve te ndikimit ne mjedis, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar/punësuar në kontrata/shoqeri të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë ne Inxhinieri e Mjedisit

Drejtuesi teknik te paraqese edhe nje deklaratë personale me shkrim qe nuk është i angazhuar/punësuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt .
(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, se bashku me dokumentacionin perkates)
Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentate kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencë te vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa (per 3- muajt e fundit 2022) si më poshtë:

- Inxhinier mjedisi i certifikuar per vleresimin e ndikimit ne mjedis 1 (një)

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin ekësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar per 3- muajt e fundit *punonjës të kualifikuar* për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me diplome/dëshmi/çertifikate

kualifikimi, minimalisht si më poshtë:

- Drejtues te makinave te renda me ngrites (Automakiniste) 5 (pese)
- Drejtues te makinave te renda (Eskavat., Buldozeriste, etj) 5 (pese)
- Shofer 5 (pese)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent. rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko- praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesite makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës.
- Diplome/dëshmi/çertifikate kualifikimi/profesionit perkates.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Emri i Mbiemri	Profesioni	Kodi i deklarimit ne listpagese	Data e fillimit te marrdhenieve punes	Nr/amzes/ekuivalent diplomes/certifikate s profesionale dhe Institucioni leshues	Nr. Çertifikate se sigurimit teknik dhe Institucioni leshues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 1 (një) punonjës inxhinier i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës inxhinier të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe

profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **20 (njëzet) punonjës** përfshirë edhe stafin e kualifikuar (në pikën 2.3.5) për periudhën e **3 muajve te fundit 2023**.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e **3 muajve te fundit 2023**
- b) Listëpagesat sipas formës E-Sig 025/a që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e **3 muajve te fundit 2023**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9 si dhe deklaratave perkatëse të kerkuara.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Prandaj në lidhje me percaktimin e numrit të punonjësve është përdorur edhe eksperiencia e mëparshme ndër vite duke qenë se edhe nga eksperiencia e të gjitha këtyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshëm një numër i tillë punëtorësh për të realizuar shërbimin e mirëmbajtjes

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 :2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim
- Certifikatë **ISO 14001 : 2015** mbi **“Sistemet e menaxhimit të mjedisit”**, e vlefshme, ose ekuivalente/barasvlefshme lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **OHSAS 18001-2007** mbi **“Shëndetin dhe Sigurimin në punë”** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim dhe/ose certifikatën ekuivalente të njohur nga standardet shqiptare **ISO 45001 – 2018**.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a” dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Gjithashtu, Autoriteti kontraktor(AK) kërkon këto certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, për të vërtetuar pajtueshmërinë e operatoritekonomik ofertuesi me standardet e kërkuara, gjithashtu edhe për të pasur garanci që operatorët ofertuesmbulojnë menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike qëka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes mbi 20 ton	në pronësi ose me qera	cope	2
2	Fadrome me goma	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se 3.5 ton	në pronësi ose me qera	cope	4
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
5	Buldozier me zinxhir	në pronësi ose me qera	copë	2
6	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qera	cope	2
7	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qera	cope	1
8	Minieskavator	ne pronesi ose me qira	cope	1
9	Minifadrome me goma	ne pronesi ose me qira	cope	1
10	Rimorkiator	në pronësi ose me qera	cope	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si më poshtë vijon:

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pese) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) cope

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerases, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*

b) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratënga administratori i shoqërisë ofertuese).*

c) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura ne te cila Operatori ekonomik eshte shpalluir fitues (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

e) Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me makinerite/pajisjet qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Lloji i mjetit dhe shasia/targamëneska	Specifikime teknikesi tonazhi, kapaciteti mbajtes etj.	Pronesi/Qiraja	Data e nenshkrimite kontratese qirase/blerjes	Vendodhja e mjetit me qellim verifikimi
----	--	--	----------------	---	---

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për përmbushjen e këtij kriteri (2.3.9), operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 8). Për rrjedhojë, si përshumicën e kriterëve të përcaktuara nga AK, ”përmbajtja e dëshmimeve/të dhënave që vërtetojnë nëse mjetet dhe pajisjet teknike janë në pronësi ose me qira duhet të pasqyrohen në seksione të ndara sipas përmbajtjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, përkatësisht tek Shtojca 8, Pjesa III/C “Përdisponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 82 të LPP dhe nenin 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ndërkohë, për të gjitha deklaratat e operatorit ekonomik të pasqyruara në shtojcën 8, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme ***mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomikose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, bazuar në pikën 7 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021*** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i makinerive është kryer nga specialisti i fushës së ndërtimit pas zbrërthimit analitik të zëravetë punimeve të preventivit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar.

Pavarësisht, se gjatë fazës së ofertimit mjafton përcaktimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, në bazë të nenit 26/6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara të dorëzuara në sistem. Sqarojmë se dokumentet provuese janë përcaktuar në bazë të ligjit nr. 63/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (neni 42 dhe neni 47), ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe deklaratave perkatëse të kërkuara.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa me sipër, do të

dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit